

PASQYRAT FINANCIARE

(Mbështetur në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të ndryshuar, dhe në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK 2)

Të dhëna identifikuese

- Emri “NDERMARJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2 ” Sh.a.
- NIPT K 51730022 L
- Adresa Rruga “Artan Lenja” Tirane
- Data e krijimit 20.06.2005
- Nr Regj Tregt ____33 932____
- Fusha e veprimtarisë _Trajtim i studenteve te Fakultetit te Inxhinjerise se Ndertimit, Mjekesise,Infermjerise dhe Universitetit te Sporteve, Tirane per fjetje dhe ushqim,etje_

Të dhëna të tjera

- Individuale
- Pasqyra financiare Të konsoliduara
- Monedha LEK
- Rrumbullakimi _____
- Periudha Kontabël
Nga 01.01.2013 Deri 31.12.2013
- Data e plotësimit të PF 22.03.2014

AKTIVET

Nr. Ref.	AKTIVET	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
I	Aktive Afatshkurtra	51,628,931	45,372,577
1	Mjetet Monetare	44,353,921	37,829,803
2	Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim	-	-
a)	Derivatet	-	-
b)	Aktivet e mbajtur per tregtim	-	-
	Totali 2	-	-
3	Aktive te tjera Financiare afatshkurter	2,525,509	2,525,509
a)	Llogari kerkesa te arketueshme	-	-
b)	Llogari kerkesa te tjera te arketueshme	2,525,509	2,525,509
c)	Instrumente te tjera borxhi	-	-
d)	Investime te tjera financiare	-	-
	Totali 3	2,525,509	2,525,509
4	Inventari	4,749,501	5,017,265
a)	Lendet e para	4,749,501	5,017,265
b)	Prodhimi ne proces		
c)	Produkte te gatshme		
d)	Mallra per rishitje	-	-
e)	Parapagesat per furnizime		
	Totali 4	4,749,501	5,017,265
5	Aktive Biologjike afatshkurter		
6	Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje		
7	Parapagime dhe shpenzime te shtyra	-	-
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	51,628,931	45,372,577
II	Aktive Afatgjata	755,009,578	780,941,798
1	Investime financiare afatgjata	-	-
a)	Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	-	-
b)	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje	-	-
c)	Aksione dhe letra te tjera me vlere	-	-
ç)	Llogari kerkese te arketueshme	-	-
	Totali 1	-	-
	Aktive Afatgjata Materiale	755,009,578	780,941,798
a)	Ndertime ne Proces	374,855,914	374,855,914
b)	Ndertesa (neto)	347,550,399	365,842,525
c)	Makineri dhe pajisje (neto)	12,691,402	15,562,751
ç)	Aktive te tjera afatgjata materiale (neto)	19,911,863	24,680,607
	Totali 2	755,009,578	780,941,798
3	Aktive Biologjike Afatgjate		
4	Aktive Afatgjata Jomateriale		
a)	Emri i mire	-	-
b)	Aktive te tjera afatgjata jomateriale	-	-
c)	Aktive te tjera afatgjata koncensione	-	-
	Totali 4	-	-
5	Kapitali aksionar i papaguar		
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)		
	Totali i Aktiveve Afatgjata	755,009,578	780,941,798
	TOTALI AKTIVEVE	806,638,509	826,314,374

DETYRIMET DHE KAPITALI

Nr. Ref.	DETYRIMET DHE KAPITALI	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
I	Detyrimet Afatshkurta	38,567,198	41,881,534
1	Derivatet		
2	Huamarrjet	19,547,441	24,777,412
a)	Huate dhe obligacionet afatshkurtra	19,547,441	24,777,412
b)	Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata	-	-
c)	Bono te konvertueshme	-	-
	Totali 2	19,547,441	24,777,412
3	Huate dhe parapagimet	19,019,758	17,104,122
a)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	11,095,105	13,308,231
b)	Te pagueshme ndaj punonjesve	27,818	10,528
c)	Detyrimet tatimore	2,858,937	3,442,916
ç)	Hua te tjera	355,898	342,447
d)	Parapagimet e arketueshme	4,682,000	-
	Totali 3	19,019,758	17,104,122
4	Grantet dhe te ardhura te shtyra		
5	Provizionet afatshkurtra		
	Detyrime Totale Afatshkurtra	38,567,198	41,881,534
II	Detyrimet Afatgjata	73,675,838	77,479,995
1	Huate afatgjata	-	-
a)	Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	-	-
b)	Bonot e konvertueshme	-	-
	Totali 1	-	-
2	Huamarrje te tjera afatgjata	-	-
3	Grandet dhe te ardhura te shtyra	72,278,992	76,083,149
4	Rrimarrje Subvencionesh	1,396,846	1,396,846
	Detyrime Totale Afatgjata	73,675,838	77,479,995
	Detyrime Totale	112,243,036	119,361,529
III	Kapitali	694,395,473	706,952,845
1	Akisonet e pakices		
2	Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		
3	Kapitali i aksionar	710,350,000	710,350,000
4	Primi i aksionit		
5	Njesite ose aksionet e thesarit		
6	Rezerva statutore		
7	Rezerva ligjore	204,143	204,143
8	Rezerva te tjera	3,470,856	3,470,856
9	Fitimi i pashperndare	(7,072,154)	-
10	Fitimi (humbje) e vitit financiar	(12,557,372)	(7,072,154)
	Totali i Kapitalit	694,395,473	706,952,845
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	806,638,509	826,314,374

**PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)**

Nr. Ref.	Pershkrimi	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
	Te Ardhurat	178,119,642	173,432,838
1	Shitjet neto	101,458,605	97,005,209
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit (Qerate)	3,804,157	5,194,540
3	Te Ardhura nga Subvencionet	72,856,880	71,233,089
4	Materialet e konsumuara	(16,530,729)	(17,476,616)
5	Kosto e punës	(104,909,887)	(94,257,387)
a)	-pagat e personelit	(84,154,881)	(81,817,361)
b)	-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	(13,941,324)	(12,440,026)
c)	shpenzimet per dieta	(6,813,682)	-
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet	(22,185,008)	(27,201,028)
7	Shpenzime të tjera	(45,681,266)	(39,481,588)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)	(189,306,889)	(178,416,619)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)	(11,187,247)	(4,983,781)
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e	-	-
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet	-	-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	(1,370,124)	(2,090,373)
12/a	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera	-	(2,674,378)
12/b	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	(1,374,198)	584,005
12/c	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	-	-
12/d	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	4,074	-
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)	(1,370,124)	(2,090,373)
	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	(12,557,372)	(7,074,154)
14	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-	-
15	Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	(12,557,372)	(7,074,154)

PASQYRA E FLUKSIT MONETAR
(Metoda direkte)

Nr. Ref.	Fluksi Monetar	Viti Ushtimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
I			
1	Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	6,122,196	12,219,851
a)	Mjetet monetare (MM) të arkëtuara nga klientët	178,578,510	173,434,838
b)	MM të paguara ndaj furnitorëve, punonjësve dhe taksa të #	(172,456,314)	(160,761,335)
c)	MM të ardhura nga veprimtaritë	-	-
d)	Interesi i paguar	-	-
e)	Tatim mbi fitimin i paguar	-	(453,652)
	<i>MM neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>	<i>6,122,196</i>	<i>12,219,851</i>
2	Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	4,206,080	(28,518,805)
a)	Blerja e njësisë së kontrolluar X minus paratë e Arkëtuara		
b)	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(1,034,200)	(28,518,805)
c)	Të ardhurat nga shitja e pajisjeve	4,781,412	
d)	Interesi i arkëtuar	458,868	-
e)	Dividendët e arkëtuar		-
	<i>MM neto të përdorura në veprimtaritë investuese</i>	<i>4,206,080</i>	<i>(28,518,805)</i>
3	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare	(3,804,157)	(4,412,663)
a)	Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	-	-
b)	Të ardhura nga huamarrje afatgjata	(3,804,157)	(4,004,376)
c)	Pagesat e detyrimeve të tjera		-
d)	Dividendë të paguar		(408,287)
	<i>MM neto e përdorur në veprimtaritë financiare</i>	<i>(3,804,157)</i>	<i>(4,412,663)</i>
4	Rritja/rënia neto e mjeteve monetare	6,524,118	(20,711,617)
5	Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	37,829,803	58,541,420
6	Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	44,353,921	37,829,803
		44,353,921	37,829,803

PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT
(b) Në një pasqyrë të pakonsoliduar

Levizja e Kapitaleve	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2011	710,350,000			3,674,999		714,024,999
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						
Pozicioni i rregulluar						
Fitimi neto për periudhën kontabël					(7,072,154)	
Dividendët e paguar						
Rritje e rezervës së kapitalit						
Emetimi i aksioneve						
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	710,350,000	-	-	3,674,999	(7,072,154)	706,952,845
Fitimi neto për periudhën kontabël					(12,557,372)	
Dividendët e paguar						
Emetim i kapitalit aksionar						
Aksione të thesarit të riblera						
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	710,350,000	-	-	3,674,999	(19,629,526)	694,395,473

SHENIME SHPJEGUESE

Shoqëria “ NDERMARJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” Sh.a. i ka ndertuar Pasqyrat Financiare në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK2. Shoqëria i ndërton dhe i paraqet Pasqyrat Financiare sipas SKK në bazë të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 4. Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar **Politikat Kryesore Kontabel** si : politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e te drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve si dhe njohjen dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë pasur parasysh **Parimet** informacionit: si Parimi i te drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimesise së veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit. **Karakteristikat** çilesore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë ato që e bëjnë informacionin e pasqyrave financiare të dobishëm për përdoruesin. Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë : Kuptueshmëria, Rendesia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i Paraqitjes me Besnikëri parimi i Perparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore, Paanshmëria, Parimi i maturisë, Parimi i plotësisë. Qëndrueshmëria dhe Krahasueshmëria .

Përmbledhje e politikave kontabel

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar “ Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare “ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të konstatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit zbatohen për herë të dytë dhe aplikimi i tyre, sipas kërkesave të SNK-ve, është bërë në mënyrë perspektive. Si pasojë shifrat e 2013 janë të krahasueshme me ato të vitit 2012, pasi janë zbatuar politika kontabel të njejta.

Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2013 është zbatuar formati i SKK-2 si edhe në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2012.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lek, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në cdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

“NDERMARRJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2”SH.A

Kurset e këmbimit të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore më 31.12.2013:

Monedha	Viti 2013	Viti 2012	Ndryshimi
Euro	140,20	139,59	+0,61
USD	101,86	105,85	-3,99
GBP	168,39	171,18	+2,79
CAD	95,70	106,37	-10,67

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi I pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm I cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 10 %.

Kerkesat për t'u arketuar

Kerkesat për t'u arketuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arketuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuara. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arketuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënje në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme.

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme.

Aktivitet Afatgjata Materiale

Aktivitet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element I AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat I rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin “tepricë nga rivlerësimi”. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat I rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndërtesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura janë në ndërtesa 5% të vlerës së mbetur dhe për aktivet e tjera 20% dhe 25% të vlerës së mbetur.

Gjendjet e inventarët

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është cmuar si vlera neto e realizueshme.

Ne vijim do të interpretojmë vlerat e paraqitura në pasqyrat përkatëse.

AKTIVET

Bilanci Kontabël nis me Zeri I.1. *Aktive monetare* të cilat arrijnë në fund të vitit vlerën 44 353 921,27 leke. Zëri I.3. (i) *Paraqet vleren e Kerkesave te arketueshme nga klientet* per ZERO leke, Zeri I.3. (ii) *Kerkesa te tjera te Arketueshme* per 2 525 509 leke paraqet vleren kerkesave ndaj studenteve per me shume se dhjete vite per te cilat eshte krijuar edhe provizioni per 1 396 846 leke si dhe kerkesa te krijuara deri ne mbyllje te vitit 2012 per 1 128 663 leke. Zëri I.4. (iv) *Inventare* paraqet vlerën e materialeve ,mallrave e materiale pastrimi per 4 749 501,12 leke gjendjen në magazinë të cilat do të perdoren ne vitin pasardhës. Për të vlerësuar lëndët e para është ndjekur politika e vlerësimit të inventarit me cminin e mesatare

Totali i Aktiveve Afatshkurtera per 51 628 931,39 leke

Aktivitet Afatgjata perbehen nga Zeri II.2.(i) *Toka* 374 855 914,00 leke perfaqeson token ne pronesi te shoqerise. Zeri II.2.(ii) *Ndertesave* per 347 550 398,85 leke perfaqeson vleren ndertesave e ndertimeve e vlere neto per vitin 2013 llogaritur amortizim.Zeri II.2.(iii) *Makineri e Paisje* perfaqeson vleren e mbetur te AQT(makineri e paisje e mjete transporti) nga vlera e blerjes eshte zbritur amortizimi i ne mbyllje te vitit 2013 per 12 691 401,80 leke.Zeri II.2.(iv) *Aktive te tjera afatgjata materiale* perfaqeson vleren e mbetur te paisjeve te zyres,atyre informatike dhe te tjera aktive pra vlera fillestare e blerjes minus amortizimin e akumuluar per 19 911 863,25 leke

Totali i Aktiveve Afatgjata 755 009 577,90 leke.

AKTIVET TOTALI 806 638 509,29 leke

DETYRIMET DHE KAPITALI

Për pjesën e detyrimeve Zeri I 2.(i) *Huate dhe Oblikacionet Afatshkurtera* hua afatshkurtera (Overdrafft) per 19 547 440,58 leke , Zërin I.3.(i) *Te pagueshme ndaj furnitoreve* perfaqeson detyrimet e shoqerise ndaj furnitorëve 11 095 104,85 leke te cilet perfaqesojne të gjithë furnitorët ende te palikujduar deri në 31 dhjetor 2013. Zeri I .3.(ii) *Te pagueshme ndaj punonjesve* per pagat e muajit dhjetor jane diferenca te papaguara qe paguhen ne fillim te vitit te ardhshem per 27 818 leke. Zeri I.3.(iii) *Detyrime Tatimore* per 2 858 936,71 leke janë detyrimet e shoqerise per sigurimet shoqerore ,tatim mbi pagat detyrime qe do te likujdohen ne fillim te vitit pasardhes.Zëri 3. (iv) *Hua te tjera* ne vleren 355 898,25 lekë janë të pasqyruara detyrimet e shoqerise ndaj te treteve . Zëri II 1. (i) *Hua afatgjata per zero perfaqeson detyrime nda bankave per hua afatgjata*,Zëri 3. (iii) *Grande Afatgjata perfaqeson grandet e marra gjate periudhave te vitit 2012 per 72 278 991,85 leke dhe vlera 1 396 846 leke perfaqeson rrimarrjen e subvencioneve.*

Totali Detyrime per 112 243 036,24 leke

Ne pjesen III **KAPITALI** Zeri III. 3.*Kapitali Aksionar* në vlerën 710 350 000 leke perfaqeson vleren e kapitalit te nenshkruar. Zeri III.7. *Rezervat* per 204 143 leke, dhe 3 470 856 leke perfaqeson rezervat ligjore dhe rezervave te tjera ,shoqeria nuk ka krijuar rezerva gjate vitit 2013. Zeri III.9.*Fitimi e humbje te mbartura* perfaqeson humbjen e shoqerise në vlerën 7 072 154 lekë e krijuar deri ne vitin 2012.Zeri III.10.*Fitimi i vitit financiar* perfaqeson humbjen e shoqerise në vlerën 12 557 371,95 lekë e krijuar vetem ne vitin 2013

DETYRIMET DHE KAPITALI TOTALI 806 638 509,29 leke

TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzime e ndërtuar sipas Natyrës, fillon me : Zëri 1. *Shitjet neto* janë 101 458 605 lekë perfaqeson te ardhura nga veprimtaria kryesore per vitin 2013 si dhe te te ardhura nga rrimarje subvencionesh per 3 804 157,15 leke Zëri 2. Te Ardhura te tjera nga subvencionet per 72 856 880 leke.Zeri 4.*Materialet e konsumuara* per 16 530 728,61 leke perben vleren e blerjes se mallrave gjate periudhes deri ne 31 dhjetor 2013 si dhe gjendjet e inventarit te perdorura, duke ndjekur edhe në dalje politikën e vlerësimit të inventarëve me metoden mesatare si dhe shpenzimet e magazinimit . Zeri 5.*Kosto e punës* për këto shitje arrin në vlerën prej 104 909 886,66 leke,nga te cilat për *pagat e punonjësve* dhe 84 154 881 leke, nga *sigurimet shoqërore* 13 941 323,66 leke, dhe shperblime e ndihma ekonomike si dhe pagesa e keshillit mbikqyres per 6 813 682 leke. Zeri 6. *Amortizime dhe zhvleresime* kemi vleren 22 185 007,61 leke shoqeria ka llogaritur amortizim per vitin 2013. Zeri 7. *Shpenzimeve të tjera* per 45 681 266,07 janë Shpenzimet per Furnitura nentrajttime e sherbime,tatime e taksa te tjera. Zeri 9. *Fitim apo humbja nga veprimtaria kryesore* humbja per 11 187 246,80 leke perfaqeson diferencen e Te ardhurave nga shitja me shpenzimet direkte te ushtrimit. Zeri 12. *Te ardhura ose Shpenzime financiare* jane 1 370 125,15 leke qe perfaqesojne: Zeri 12.2 *Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat* (shpenzime) 1 374 198,90 leke, Zeri 12.3. *Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit* si rezultat i transaksioneve në valutë (te ardhura) prej zero leke , Zeri 12.4. *Te tjera financiare* perfaqeson te ardhurat te tjera per 4 073,75 leke.

Për gjithë veprimtarinë e kryer gjatë vitit korrent shoqëria ka shpenzuar për detyrim ndaj shtetit në formën e tatim fitimitper zero leke. Nga krahasimi vlerave te mesiperme del rezultati i vitit prej 12 557 371,95 leke, shifër e cila është e transferuar edhe ne bilancin kontabël në zërin përkatës te rezultatit te ushtrimit.

REZULTATI I VITIT USHTRIMOR (HUMBJA) 12 557 371,95 LEKE

HARTOI
Adrian PANO



ADMINISTRATOR
Viron BEZHANI



RAPORTI I EKSPERTEVE KONTABEL RREGJISTRUAR

Periudha 1 Janar - 31 Dhjetor 2013

24/03/2014

“NDERMARRJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2”Sh.a.

Fatbardha SHTREPI, Silvana GJKDHIMA ,Eksperte Kontabel te Rregjistruar

Permbajtja

I. RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

II. PASQYRAT FINANCIARE DERI NE 31.12.2012

- ❖ BILANCI I GJENDJES FINANCIARE
- ❖ PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE REZULTATIT
- ❖ PASQYRA E FLUKSIT MONETAR
- ❖ PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT
- ❖ PASQYRA E GJENDJES DHE NDRYSHIMEVE TE AAM

III. SHENIME PER DREJTIMIN E SHOQERISE

- 1) Te dhena te Pergjithshme mbi shoqerine
 - 2) Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel
 - 3) Organizimi i Kontabilitetit
 - 4) Shenime per Pasqyrat Financiare
-

I. Raport i Ekspertit Kontabel te Rregjistruar *Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare te Shoqerise*

“NDERMARJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” Sh.a.

Drejtuar:

1. Aksionerit te Vetem
2. Keshillit Mbikqyres
3. Administratorit

Te Shoqerise “ NDERMARJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” Sh.a.

Adresa: Rruga Artan LENJA, Tirane

Lidhur me shqyrtimin e Pasqyrave Financiare te periudhes Janar – Dhjetor 2013

Te nderuar Zoterinj !

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare bashkalidhur te shoqerise “NDERMARJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” Sh.a., per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2013, qe perfshijne Bilancin (Aktivet, Detyrimet dhe Kapitalin) dhe pasqyrat perkatese te te Ardhurave, te Fluksit te Parase dhe te Levizjeve te Kapitalit per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te Politikave Kryesore Kontabel dhe Shenimet Shpjeguese.

Pergjegjesia e Drejtimit te Shoqerise

Drejtimi i Shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te Pasqyrave Financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (S.K.K.) Kjo pergjegjesi perfshin : hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te Pasqyrave Financiare pa gabime materiale nga pasaktesia ose gabime, perzgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabel dhe berjen e vleresimeve te duhura kontabel te pershtatshme per shoqerine.

Pergjegjesia Audituesit te Pavarur

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto Pasqyra Financiare. Ne e kryem auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit (S.N.A.) Keto standarte kerkojne qe ne te permbushim kerkesat e etikes, dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale. Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per sigurimin e te dhenave te auditimit per shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura jane ne gjykim te audituesve, duke perfshire vlersimin e rrishtit te anomalive materiale si rezultat i gabimeve ose pasaktesive. Gjate vlersimit te ketyre rrezeqeve, audituesit merrin ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te Pasqyrave Financiare ne menyre qe te percaktoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat financiare, por jo per qellim te shprehjes se nje opinion per efektivitetin e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu



**Pasqyrat Financiare te Shoqerise
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2013**

vleresimin e pershtatshmerise se parimeve kontabile te perdorura dhe pranueshmerine e cmuarjeve kontabile te kryera nga drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te Pasqyrave Financiare. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin pershtatshmerise se parimeve kontabel te perdorura dhe tearsyeshmerise se cmuarjeve te rendesishme kontabel te bera nga Drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te Pasqyrave Financiare.

Ne besojme se te dhenat e auditimit qe ne kemi siguruar jane te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te bazuar opinionin tone.

Arsyet per dhenien e opinionit me rezerve jane:

- (a) Ne nuk mund te merrnim pjese gjate procesit të inventarizimit fizik të gjendjeve të inventarit të AAM deklaruar në një vlerë totale 755 009 577,18 leke me 31.12.2013, sepse kjo datë ishte para angazhimit tonë si auditues të shoqërisë, por ne jemi njohur me komisionin e kryerjes se inventareve ne fund te vitit si dhe me materialet e inventarizimit te cilat na japin pershyqjen e nje procesi te rregullt inventarizimi.

Opinion


Sipas opinionit te Eksperteve Kontabel te Rregjistruar, Pasqyrat Financiare te Shoqerise “NDERMARRJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” Sh.a.me përjashtim të efekteve te mundshme të rregullimeve nëqoftëse do kishte te tilla, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme për tu bindur sipas çështjeve të referuar në paragrafët (a-a) më sipër, Pasqyrat Financiare japin nje pamje te vertete dhe te besueshme te gjendjes financiare te Shoqerise NDERMARRJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” Sh.a., me date 31 Dhjetor 2013,si dhe te rezultateve te veprimtarive te saj per ushtrimin e mbyllur, ne pajtim me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK.) dhe respektojne Ligjin nr 9228 date 29 04 2004 ”Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Indryshuar.

Me respekt

Fatbardha SHTREPI

Silvana GJIKDHIMA

Ekspert Kontabel i Rregjistruar



Tirane, me 24 Mars 2014



Pasqyrat Financiare te Shoqerise
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2013

II. PASQYRAT FINANCIARE DERI NE 31.12.2013

❖ **AKTIVET**

Nr. Ref.	A K T I V E T	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
I	Aktive Afatshkurtra	51,628,931	45,372,577
1	Mjetet Monetare	44,353,921	37,829,803
2	Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim	-	-
a)	Derivatet	-	-
b)	Aktivitet e mbajtur per tregtim	-	-
	Totali 2	-	-
3	Aktive te tjera Financiare afatshkurter	2,525,509	2,525,509
a)	Llogari kerkesa te arketueshme	-	-
b)	Llogari kerkesa te tjera te arketueshme	2,525,509	2,525,509
c)	Instrumente te tjera borxhi	-	-
d)	Investime te tjera financiare	-	-
	Totali 3	2,525,509	2,525,509
4	Inventari	4,749,501	5,017,265
a)	Lendet e para	4,749,501	5,017,265
b)	Prodhimi ne proces		
c)	Produkte te gatshme		
d)	Mallra per rishitje	-	-
e)	Parapagesat per furnizime		
	Totali 4	4,749,501	5,017,265
5	Aktive Biologjike afatshkurter		
6	Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje		
7	Parapagime dhe shpenzime te shtyra	-	-
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	51,628,931	45,372,577
II	Aktive Afatgjata	755,009,578	780,941,798
1	Investime financiare afatgjata	-	-
a)	Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	-	-
b)	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje	-	-
c)	Aksione dhe letra te tjera me vlere	-	-
ç)	Llogari kerkese te arketueshme	-	-
	Totali 1	-	-
1	Aktive Afatgjata Materiale	755,009,578	780,941,798
a)	Ndertime ne Proces	374,855,914	374,855,914
b)	Ndertesa (neto)	347,550,399	365,842,525
c)	Makineri dhe pajisje (neto)	12,691,402	15,562,751
ç)	Aktivite te tjera afatgjata materiele (neto)	19,911,863	24,680,607
	Totali 2	755,009,578	780,941,798
3	Aktive Biologjike Afatgjate		
4	Aktive Afatgjata Jomateriale		
a)	Emri i mire	-	-
b)	Aktive te tjera afatgjata jomateriele	-	-
c)	Aktive te tjera afatgjata koncensione	-	-
	Totali 4	-	-
5	Kapitali aksionar i papaguar		
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)		
	Totali i Aktiveve Afatgjata	755,009,578	780,941,798
	TOTALI AKTIVEVE	806,638,509	826,314,374



Pasqyrat Financiare te Shoqerise
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2013

❖ **DETYRIMET DHE KAPITALI**

Nr. Ref.	DETYRIMET DHE KAPITALI	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
I	Detyrimet Afatshkurta	38,567,198	41,881,534
1	Derivatet		
2	Huamarrjet	19,547,441	24,777,412
a)	Huate dhe obligacionet afatshkurtra	19,547,441	24,777,412
b)	Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata	-	-
c)	Bono te konvertueshme	-	-
	Totali 2	19,547,441	24,777,412
3	Huate dhe parapagimet	19,019,758	17,104,122
a)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	11,095,105	13,308,231
b)	Te pagueshme ndaj punonjesve	27,818	10,528
c)	Detyrimet tatimore	2,858,937	3,442,916
ç)	Hua te tjera	355,898	342,447
d)	Parapagimet e arketueshme	4,682,000	-
	Totali 3	19,019,758	17,104,122
4	Grantet dhe te ardhura te shtyra		
5	Provizionet afatshkurtra		
	Detyrime Totale Afatshkurtra	38,567,198	41,881,534
II	Detyrimet Afatgjata	73,675,838	77,479,995
1	Huate afatgjata	-	-
a)	Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	-	-
b)	Bonot e konvertueshme	-	-
	Totali 1	-	-
2	Huamarrje te tjera afatgjata	-	-
3	Grandet dhe te ardhura te shtyra	72,278,992	76,083,149
4	Rrimarrje Subvencionesh	1,396,846	1,396,846
	Detyrime Totale Afatgjata	73,675,838	77,479,995
	Detyrime Totale	112,243,036	119,361,529
III	Kapitali	694,395,473	706,952,845
1	Akisonet e pakices		
2	Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		
3	Kapitali i aksionar	710,350,000	710,350,000
4	Primi i aksionit		
5	Njesite ose aksionet e thesarit		
6	Rezerva statutore		
7	Rezerva ligjore	204,143	204,143
8	Rezerva te tjera	3,470,856	3,470,856
9	Fitimi i pashperndare	(7,072,154)	-
10	Fitimi (humbje) e vitit financiar	(12,557,372)	(7,072,154)
	Totali i Kapitalit	694,395,473	706,952,845
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	806,638,509	826,314,374



❖ **PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**

(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

Nr. Ref.	Pershkrimi	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
	Te Ardhurat	178,119,642	173,432,838
1	Shitjet neto	101,458,605	97,005,209
2	Të ardhura të tjera nga veprimtari të e shfrytëzi mit (Qerate	3,804,157	5,194,540
3	Te Ardhura nga Subvencionet	72,856,880	71,233,089
4	Materialet e konsumuara	(16,530,729)	(17,476,616)
5	Kosto e punës	(104,909,887)	(94,257,387)
a)	-pagat e personelit	(84,154,881)	(81,817,361)
b)	-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	(13,941,324)	(12,440,026)
c)	shpenzimet per dieta	(6,813,682)	-
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet	(22,185,008)	(27,201,028)
7	Shpenzime të tjera	(45,681,266)	(39,481,588)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)	(189,306,889)	(178,416,619)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)	(11,187,247)	(4,983,781)
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e	-	-
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet	-	-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	(1,370,124)	(2,090,373)
12/a	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të	-	(2,674,378)
12/b	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	(1,374,198)	584,005
12/c	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	-	-
12/d	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	4,074	-
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)	(1,370,124)	(2,090,373)
	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	(12,557,372)	(7,074,154)
14	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-	-
15	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	(12,557,372)	(7,074,154)



❖ **PASQYRA E FLUKSIT MONETAR**
(Metoda direkte)

Nr. Ref.	Fluksi Monetar	Viti Ushtrimor	
		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
I			
1	Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	6,122,196	12,219,851
a)	Mjetet monetare (MM) të arkëtuara nga klientët	178,578,510	173,434,838
b)	MM të paguara ndaj furnitorëve, punonjësve dhe taksa t	(172,456,314)	(160,761,335)
c)	MM të ardhura nga veprimtaritë	-	-
d)	Interesi i paguar	-	-
e)	Tatim mbi fitimin i paguar	-	(453,652)
	<i>MM neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>	<i>6,122,196</i>	<i>12,219,851</i>
2	Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	4,206,080	(28,518,805)
a)	Blerja e njësisë së kontrolluar X minus paratë e Arkëtuara		
b)	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(1,034,200)	(28,518,805)
c)	Të ardhurat nga shitja e pajisjeve	4,781,412	
d)	Interesi i arkëtuar	458,868	-
e)	Dividendët e arkëtuar		-
	<i>MM neto të përdorura në veprimtaritë investuese</i>	<i>4,206,080</i>	<i>(28,518,805)</i>
3	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare	(3,804,157)	(4,412,663)
a)	Të ardhura nga emtimi i kapitalit aksionar	-	-
b)	Të ardhura nga huamarrje afatgjata	(3,804,157)	(4,004,376)
c)	Pagesat e detyrimeve të tjera		-
d)	Dividendë të paguar		(408,287)
	<i>MM neto e përdorur në veprimtaritë financiare</i>	<i>(3,804,157)</i>	<i>(4,412,663)</i>
4	Rritja/rënia neto e mjeteve monetare	6,524,118	(20,711,617)
5	Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	37,829,803	58,541,420
6	Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	44,353,921	37,829,803
		44,353,921	37,829,803



❖ **PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT**
(b) Në një pasqyrë të pakonsoliduar

Levizja e Kapitaleve	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2011	710,350,000			3,674,999		714,024,999
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						
Pozicioni i rregulluar						
Fitimi neto për periudhën kontabël					(7,072,154)	
Dividendët e paguar						
Rritje e rezervës së kapitalit						
Emetimi i aksioneve						
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	710,350,000	-	-	3,674,999	(7,072,154)	706,952,845
Fitimi neto për periudhën kontabël					(12,557,372)	
Dividendët e paguar						
Emetim i kapitalit aksionar						
Aksione të thesarit të riblera						
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	710,350,000	-	-	3,674,999	(19,629,526)	694,395,473



Pasqyrat Financiare te Shoqerise
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2013

❖ **PASQYRA E GJENDJES DHE NDRYSHIMEVE TE AAM-ve**

	Toka	Ndertesa	Makineri & Pajisje	Mjete transporti	Zyre dhe Informatike	Totali
<u>VLERA E DREJTE BRUTO</u>						
Ne 1 Janar 2013	374,855,914	640,878,031	35,051,921	10,402,517	80,417,696	1,141,606,079
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 1 Janar 2013 pas ndryshimeve	374,855,914	640,878,031	35,051,921	10,402,517	80,417,696	1,141,606,079
Shtesa		-	268,800	-	765,400	1,034,200
Pakesime		-	(142,000)	-	(4,639,412)	(4,781,412)
Riklasifikime				-		-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	374,855,914	640,878,031	35,178,721	10,402,517	76,543,684	1,137,858,867
<u>AMORTIZIMI AKUMULUAR</u>						
Ne 1 Janar 2013	-	275,035,506	23,090,692	6,800,995	55,737,089	360,664,281
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 1 Janar 2013	-	275,035,506	23,090,692	6,800,995	55,737,089	360,664,281
Amortizimi i vitit	-	18,292,126	2,419,846	720,304	5,002,058	26,434,335
Pakesime	-	-	(190,211)	-	(4,059,116)	(4,249,327)
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	-	293,327,632	25,320,327	7,521,299	56,680,031	382,849,289
<u>VLERA E DREJTE NETO</u>						
Me 31 Dhjetor 2012	374,855,914	365,842,525	11,961,229	3,601,522	24,680,607	780,941,797
Me 31 Dhjetor 2013	374,855,914	347,550,399	9,858,394	2,881,218	19,863,653	755,009,578



III.SHENIME PER DREJTIMIN E SHOQERISE

Shoqeria: “NDERMARRJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2 “ SH.A. TIRANE

Periudha ushtrimore 01 Janar 2013 deri me 31 Dhjetor 2013

1) TE DHENA TE PERGJITHSHME TE SHOQERISE

Shoqeria **“NDERMARJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” SH.A,** eshte krijuar me date 20/06/2005. Me date 07/09/2005, me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr 33 932, Shoqeria eshte rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar. Krijimi i kesaj shoqerie eshte bazuar ne ligjin Nr.7638 Dt.19.11.1992 “ Per Shoqerite Tregtare”, Shoqeria ne baze te ketij ligji Seksioni III, Neni 94,95 eshte shenderuar dhe funksionon si Shoqeri Anonime. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi si dhe nga Statuti i saj.

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne Shqiperi, me adrese :Rruga Artan LENJA, Tirane

Ajo eshte regjistruar prane organeve tatimore te rrethit Tirane me NIPT K 51730022 L

Objekti i veprimtarise se Shoqerise **“NDERMARJA TRAJTIMIT STUDENTEVE NR 2” SH.A,** konsiston ne **“Trajtimi i Studenteve te Fakultetit te Inxhinerise,Ndertimit,Mjekesise,Infermjerise dhe te Universitetit te Sportrve,Tirane,per fjetje dhe ushqim.Shoqria ka kontrata pergjithesisht per te gjitha furnizimet per te kryer veprimtarine e saj.**

Veprimtaria e Shoqerise zhvillohet ne nje afat kohor te pa caktuar.

a) Kapitali dhe pronësia

Kapitali i Shoqerise ne momentin e krijimit te saj eshte 391 927 747 leke. Gjate gjithe periudhes qe nga krijimi i shoqerise se deri ne 31.12.2013 kapitali i shoqerise ka pesuar disa here ndryshime duke u zvogeluar dhe zmadhuar .Te gjitha ndryshimet ne kapitalin e shoqerise jane bere ne zbatim te legjislacionit ne fuqi sipas periudhes kur kane ndodhur dhe jane rregjistruar ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane dhe ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit. Ne dt 31.12.2013 Kapitali aksionar i Shoqerise eshte 710 350 000 leke. Numri kontributeve ne aksione eshte 710 350, Vlera nominale e kontributit 1 000 leke. Aksioner i vetem i Shoqerise eshte Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes, Perqindja e pjesmarjes 100%.

b) Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i pershtaten natyres se Shoqerise dhe realizimit te objektit të veprimtarisë së saj. Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise ne 31.12.2013 eshte z Viron Bezhani . Gjate vitit 2013 kane ndodhur ndryshime te Perfaqesuesi ligjor i Shoqerise.



Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2013

Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administrimi e ushtron funksionin e tij nen kontrollin e keshillit mbikqyres i cili organi vendimmarres i Shoqerise.

Anetaret e keshillit mbikqyres ne dt.31.12.2013 jane:

- Dhurata SHAMIA
- Ergys QIRICI
- Pellumb KARAMETA

Ndryshimet ne Administrimin e Shoqerise dhe ne perberjen e Keshillit Mbikqyres jane pasqyruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit .

2) MBI KONTABILITETIN

A. Baza e pergatitjes

a) Deklarata e perputhshmërisë

Pasqyrat financiare nuk janë përgatitur ne përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te Publikuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit dhe interpretimeve. Standardet janë zbatuar deri në nivelin e që ato janë përkthyer dhe adoptuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK).

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar ne parimin e kostos historike, si dhe ne raportin e eksperteve te vleresimit dhe te eksperteve kontabel te autorizuar te vitit 2008

b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne Lek, e cila është monedhe funksionale për shoqërinë.

c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë si pasoje e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët me poshtë:

i. Humbje nga rënia e vlerës se aktiveve financiare

Shoqëria teston vlerën e aktiveve te saj financiare rregullisht per te konstatuar renie te mundshme vlere. Për te përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur ne pasqyrën e te ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë te dhëne te dallueshme qe te ketë një rënie te matshme ne flukset monetare te pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja te identifikohet e ekspozuar individualisht ne portofol.



Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2013

Kjo evidence mund te përfshije te dhëna te dallueshme qe tregojnë se ka pasur një ndryshim jo te favorshëm ne gjendjen e pagesave te klienteve ne Shoqëri, apo ne gjendjen ekonomike kombëtare apo lokale qe lidhet me mospagesat ne aktivet e Shoqërisë.

ii. Përcaktimi i vlerës se drejte

Përcaktimi i vlerës se drejte për aktivet financiare dhe detyrimet për te cilat nuk ka një çmim tregu te dallueshëm, kërkohet përdorimi i teknikave vlerësuese siç përshkruhet ne shënimin 4 ne pasqyrat financiare.

iii. Përlllogaritja e tatim fitimit

